



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISTINA

Rr. "George Bush", Ndërtesa e Rektoratit, Nr. 31, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 649
Data: 27 / 3 / 2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 20, si dhe në zbatim të nenit 91 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.02.2025, mori këtë:

V E N D I M


- I. Miratohet Rregullorja e Përgjithshme për Studimet e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës.
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë Rregullorja e Përgjithshme për Studime të Doktoratës.
- III. Me hyrje në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Rregullorja me numër protokollit 937 e datës 26.04.2023, për studimet e doktoratës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

A r s y e t i m

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 20, në zbatim të nenit 91 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.02.2025, me qëllim të harmonizimit të akteve ligjore me Statutin në fuqi të Universitetit të Prishtinës, dhe domosdoshmërinë për hartimin e një Rregullore e cila përcakton kriteret unike për organizimin, zhvillimin dhe llojet e studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës (UP), me qëllim të funksionimit të mekanizmave si strukturën, kohëzgjatjen, kriteret e pranimit, procesin akademik, të drejtat dhe detyrimet e doktorantëve e mentorëve si dhe sigurimin e cilësisë së studimeve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Njësive akademike të UP-së
2. Zyrës për Çështje të studentëve;
3. Zyrës për Çështje akademike;
4. Zyrës Ligjore;
5. Arkivës së UP-së.



Kryesues i Senatit të UP-së

Prof. Arben Hajrullahu, Rektor